

Qenie të Barabarta, të Drejta të Ndryshme?

Fleta e Mësuesit

Vlerat

Barazia midis etnive dhe minoriteteve, Respekt, Tolerancë, Mirëkuptim.

Objektivat

Pedagogjike: Nxiti analizën, reflektimin dhe debatin mbi barazinë dhe jo-diskriminimin lidhur me origjinën etnike ose raciale dhe minoritetet.

Praktike: Analizimi i artikujve të shtypit që lidhen me Barazinë – çështjet e Racave dhe Minoriteteve; Përgatitja e një fushatë ndërgjegjësuere për Komunitetin Rom në vendin tuaj.

Pjesëmarrësit

Minimumi: 5 pjesëmarrës
Maksimumi: 30 pjesëmarrës

Kohëzgjatja

90 deri 120 minuta.

Materialet

Fleta e aktivitetit për secilin nxënës.

Përmbledhje

Klasa duhet të ndahet në grupe prej 4 deri në 5 nxënës. Secili grup lexon dhe analizon lajmin dhe më pas ia prezanton klasës përfundimet e tij duke u treguar i vëmendshëm që çdo nxënës i grupit të marrë pjesë në prezantim.

Më pas, secili grup përgatit një fushatë ndërgjegjësimi që duhet t'i paraqitet klasës dhe të komentohet.

Shënime

Rekomandohet që secili grup të ketë në dispozicion 30 minuta për përgatitjen dhe 5 minuta për prezantimin para klasës. Për dokumente shtesë, sugjerohet që të vizitoni faqen e mëposhtme të internetit:

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=LEGISSUM%3A129017>

<https://sq.eureporter.co/frontpage/2014/01/17/equality-eu-rules-to-tackle-discrimination-now-in-place-in-all-member-states/>

<https://sq.eureporter.co/frontpage/2014/01/17/equality-eu-rules-to-tackle-discrimination-now-in-place-in-all-member-states/>



Qenie të Barabarta, të Drejta të Ndryshme?

Fleta e Mësuesit (vazhdimi)

Diskutimi

Cili është opinionin tuaj për popullsinë romë?

A është e drejtë apo e gabuar mënyra se si trajtohet popullsia romë në vendin tuaj? Pse?

A do ta kishit problem nëse do kishit një shok klase romë? Argumentoni opinionin tuaj.


Si rezultoi përpunimi i fushatës së ndërgjegjësimit në grupin tuaj?

Mendoni se fushatat e paraqitura mund të jenë efektive?

Cilat etni apo minoritete të tjera mendoni se janë viktime të racizmit ose ksenofobisë në vendin tuaj? Pse?

Ndërkohë që po punonit për çështjen e Barazisë midis rracave dhe minoriteteve, a i ndryshuat idetë tuaja fillestare?

Nëse do të mund të bënit diçka rreth çështjeve të trajtuara në këtë aktivitet, çfarë do të bënit dhe pse?



Qenie të Barabarta, të Drejta të Ndryshme?

Fleta e Nxënësit

1) Analizoni dhe diskutoni me shokët/qet artikujt e mëposhtëm rreth Komunitetit Rom. Mbani shënim përfundimet tuaja.

**Komuniteti Rom European akoma përballet me diskriminim masiv–
Amnistia Ndërkombëtare, 8 Prill 2009 // <http://www.amnesty.org>**

Komuniteti Rom vuan diskriminim masiv në të gjithë Europën. Duke iu mohuar të drejtën e strehimit, punësimit, kujdesit shëndetësor dhe arsimimit, Romët shpesh janë viktime të dëbimeve, sulmeve raciste dhe të keqtrajttimeve të policisë.

Duke jetuar kryesisht të mënjanuar nga shoqëria, romët janë ndër komunitetet më të varfëra në Europë. Në disa vende, atyre u mohohet marrja e nënshtetësisë dhe e dokumenteve personale që kërkohen për sigurimet shoqërore, kujdesin shëndetësor dhe përfitime të tjera.

Fëmijët romë shpeshherë vendosen në mënyrë të pajustificueshme në "shkolla të veçanta" ku kurrikulat e kufizuara iu zvogëlojnë mundësitë për përmbyshjen e potencialit të tyre.

8 Prilli është **Dita Ndërkombëtare e Romëve**, një festim për kulturën rome që synon të rrisë ndërgjegjësimin për çështjet me të cilat përballen romët. Mbajtur që nga viti 1990, kjo Ditë tërheq vëmendjen ndaj diskriminimit drejtuar komuniteteve Rome dhe Cigane në nivel global.

BE dhe Romët // <http://ec.europa.eu>

Për më shumë se një mijë vjet, Romët (përfshirë Udhëtarët, Ciganët, Manouches, Ashkali, Sinti, etj.) kanë qenë pjesë integrale e qytetërimit European. Sot, me një popullsi prej 10 deri në 12 milionë banorë në Europë (rreth 6 milionë prej të cilëve jetojnë në BE), Romët janë pakica më e madhe etnike në Europë. Shumica e Romëve janë qytetarë të BE-së.

Direktiva mbi barazinë racore ndalon diskriminimin në bazë të përkatësisë racore ose etnike. Të gjitha vendet e BE-së e kanë përfshirë Direktivën në ligjet e tyre kombëtare. Megjithatë, shumë Romë ende janë viktime të paragjykitimit dhe përjashtimit social të rrënjosur thellë.



Qenie të Barabarta, të Drejta të Ndryshme?

Fleta e Nxënësit (vazhdimi)

(vazhdon)

Cilët janë Romët?

Siç përdoret më shpesh në dokumentet dhe diskutimet e politikave të BE-së, termi "Rom" këtu i referohet një numri të madh grupesh njerëzish që e përshkruajnë veten si Romë, Ciganë, Udhëtar, Manouches, Ashkali, Sinti dhe emërtime të tjera. Përdorimi i termit "Rom" nuk ka si qëllim të minimizojë shumëllojshmërinë e madhe brenda shumë grupeve të ndryshme Rome dhe komuniteteve përkatëse, as nuk synon të promovojë stereotipat.

Shumë Romë përballen me paragjykimet, intolerancën, diskriminimin dhe përjashtimin social në jetën e tyre të përditshme. Ata janë të marginalizuar dhe jetojnë në kushte shumë të vështira socio-ekonomike.

Një përgjegjësi e përbashkët

Institucionet Europiane dhe vendet e BE-së kanë përgjegjësi të përbashkët për të përmirësuar përfshirjen sociale dhe integrimin e Romëve duke përdorur të gjithë instrumentet dhe politikat përkatëse për të cilat janë përgjegjës.

Në të kaluarën, BE-ja ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme nevojën për një integrim më të mirë të Romëve, siç është ajo e Komunikatës së Prillit 2010 mbi integrimin ekonomik dhe social të Romëve në Europë.

Pavarësisht kësaj, masa të forta dhe proporcionale ende nuk janë vendosur për të trajtuar problemet e rrënjësura thellë dhe me të cilat ballafaqohet një pjesë e madhe e popullatës Rome të BE-së.

2) Pasi keni reflektuar rreth situatës së komunitetit rom në Europë, punoni në grup për të përgatitur një fushatë ndërgjegjësuese që t'ia paraqisni klasës.

Rregullat:

Të gjithë anëtarët e grupit duhet të marrin pjesë në prezantim.

- 30 minuta për përgatitjen.
- 5 minuta për prezantimin para klasës.

